



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 26/2 prot.

Tiranë më 31.01.2019

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 31.01.2019

PËR KONTROLLUESIN "INSTITUTI I TË MITURVE KAVAJË "

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "IEVP Kavajë".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 325 datë 24.12.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "IEVP Kavajë", me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga E.H, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga shtetësja me initiale E.H, lidhur me pretendimin e cënimit të të dhënave personale nga shtetasi me initiale D.C, punonjës i "IEVP Kavajë", duke përdorur dosjen personale, për qëllime jashtë atyre të përcaktuara nga Ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Ankuesja, shtetësja me initiale E.H (në cilësinë e të dëmtuarës akuzuese), ka iniciuar një proces gjyqësor ndaj shtetasit me initiale D.C (në cilësinë e të akuzuarit), pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Inspektimi u ushtrua pranë "IEVP Kavajë" pasi në funksion të Ligjit Nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe të dënuar".

Zyra e Komisionerit ka konstatuar se përfaqësuesi juridik i shtetasit me iniciale D.C nëpërmjet shkresës nr.418 prot, datë 28.04.2017, i ka kërkuar kontrolluesit “IEVP Kavajë” informacion zyrtar (publik) lidhur me sjelljen dhe procesin disiplinor të ndërmarrë më parë ndaj ankueses E.H (në cilësinë e të dëmtuarës akuzuese kundër klientit të tij), bazuar në ligjin nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Kontrolluesi “IEVP Kavajë” ka kthyer përgjigje me datë 28.04.2017 duke i vënë në dispozicion dokumentat e mëposhtëm:

1. Aktin e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Shkresa Nr.9842/1 Prot datë 24.11.2015, drejtuar IEVP Kavajë dhe për dijeni ankueses znj. E.H.;
2. Aktin e IEVP Kavajë, Shkresa Nr. 2996 Prot, datë 29.10.2015, Vendim për dhënie mase disiplinore;
3. Aktin e IEVP Kavajë, Shkresa Nr. 2990 Prot, datë 29.10.2015, Propozim mase disiplinore;
4. Raport shërbimi të IEVP Kavajë i mbajtur me datë 27.10.2015;
5. Njoftim për shqyrtim seance disiplinore, Shkresa Nr. 2998 Prot, datë 29.10.2015
6. Komunikim i masës disiplinore.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të dokumentave të sipërcituara konkludon se dokumentat e kërkuara përmbajnë informacion publik, në kuptim të nenit 2 pika 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me përjashtim të dy dokumentave “Propozimi për masë administrative” dhe “Komunikimi i masës”, që përmbajnë informacione personale të ankueses.

Lidhur me konstatimet e evidentuara gjatë hetimit administrativ, kontrolluesi “IEVP Kavajë” nëpërmjet shkresës nr. 18 prot datë 07.01.2019 ktheu përgjigje duke argumentuar mes të tjerave se: “...në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në zbatim të dispozitave të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, në datën 28.04.2017 i kemi kthyer përgjigje kërkesës së përfaqësuesit juridik të z. D.C. duke i dhënë vetëm akte administrative të prodhuara gjatë kontraktimit të subjektit E. H. Theksojmë se nuk kemi dhënë informacione mbi të dhëna sensitive, duke mos cënuar të drejtën e privatësisë të përcaktuar në nenin 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”...”

Zyra e Komisionerit, pas analizimit të provave të administruara në kuadër të hetimit administrativ dhe pretendimeve të kontrolluesit, vlerëson se pretendimi i ankueses sipas të cilës shtetasi D.C., në kuadër të aktivitetit të tij publik, ka aksesuar dokumentet e dosjes së saj të punës të administruar në kuadër të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve të punës dhe ka përdorur të dhënat e saj personale për qëllime jashtë atyre të përcaktuar nga Ligji nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nuk është i bazuar.

Kjo pasi këto të dhëna janë përhapur nga kontrolluesi “IEVP Kavajë” në adresë të përfaqësuesit juridik të D.C në cilësinë e palës ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të

iniciuar nga ankuesja, bazuar në ligjin nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Kontrolluesi “IEVP Kavajë”, në kuadër të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në përgjigjen e kthyer ndaj shkresës së datës 28.04.2017 përfaqësuesit juridik i D.C nuk ka bërë një vlerësim të duhur të ballancës ndërmjet informacionit publik dhe të dhënave personale të ankueses, duke shkelur kriteret ligjore të përpunimit të përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm që përpunimi i të dhënave të bëhet në mënyrë të drejtë dhe brenda kriterëve ligjore për garantimin dhe sigurimin e të dhënave personale.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30 dhe 31 pika 1 gërma a/1, 31/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;

#### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “IEVP Kavajë”, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar të ketë në vëmendje parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale gjatë vlerësimit të kërkesave për akses në të dhënat personale që përpunon dhe aksesin në dokumentet zyrtare që disponon.
2. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 31/1.2019

KOMISIONERI  
Besnik Dervishi

